




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister*  
Zyra për Qeverisje të Mirë/Kancelarija za Dobro Upravljanje/Office on Good Governance

# RAPORTI VJETOR



**PËR KONSULTIMET ME PUBLIKUN NË QEVERINË  
E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2018**

Mars 2019

## Përmbajtja

<i>Lista e shkurtesave.....</i>	<b>3</b>
<i>1. 1. Hyrje.....</i>	<b>4</b>
<i>2. 2. Përmbledhje Ekzekutive.....</i>	<b>6</b>
<i>3. 3. Metodologjia e raportimit dhe monitorimit të zbatimit të standardeve.....</i>	<b>7</b>
<i>4. 4. Platforma online për konsultimet publike.....</i>	<b>9</b>
<i>5. Bashkëpunimi dhe ngritja e kapaciteteve për konsultimet publike.....</i>	<b>11</b>
<i>6. Ndërlidhja e procesit të konsultimeve me publikun me zbatimin e indikatorëve të SBS-së</i>	<b>12</b>
<i>7. Numri i përgjithshëm i projekt dokumenteve.....</i>	<b>13</b>
<i>8. Shkalla e plotësimit të standardeve minimale.....</i>	<b>15</b>
<i>9. Metodatat e përdorura gjatë procesit të konsultimeve.....</i>	<b>17</b>
<i>10. Niveli i pjesëmarrjes së publikut në proces të konsultimeve.....</i>	<b>18</b>
<i>11. Numri dhe statusi i komenteve.....</i>	<b>19</b>
<i>12. Statistikat krahasuese 2017 dhe 2018.....</i>	<b>21</b>
<i>13. Konkluzionet dhe sfidat.....</i>	<b>22</b>
<i>Shrojca 1 Regjistri i dokumenteve të hartuara gjatë vitit 2018.....</i>	<b>24</b>

## Lista e shkurtesave

ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZQM	Zyra për Qeverisje të Mirë
DIEKP	Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave
KE	Komisioni Evropian
MAP	Ministria e Administratës Publike
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MBZHRD	Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MeD	Ministria e Diasporës
MF	Ministria e Financave
MFSK	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës
MI	Ministria e Infrastrukturës
MIE	Ministria e Integrimiëve
MIN	Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë
MKK	Ministria e Kthimit dhe Komuniteteve
MKRS	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MZHR	Ministria e Zhvillimit Rajonal
ReSPA	Shkolla Rajonale për Administratë Publike
RCC	Këshilli për Bashkëpunim Rajonal
SBS	Mbështetje Buxhetore Sektoriale (Sector Budget Support)

## 1. Hyrje

Progresi i arritur deri më tani në zbatimin e standardeve minimale për procesin e konsultimeve publike paraqet shembullin më të mirë të avancimit të procesit të politikë bërjes dhe hartimit të legjislacionit në Republikën e Kosovës. Përderisa gjatë vitit 2016 dhe 2017 u paraqitën sfida në ndërtimin e sistemit dhe fillimin e zbatimit të standardeve minimale, viti 2018 ka kërkuar përqendrim në zbatim dhe sigurimin e një procesi sa më kualitativ të konsultimit. Ky progres është falë punës së vazhdueshme dhe përkushtimit të Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyrës së Kryeministrit, koordinatorëve për konsultime me publikun në të gjitha ministrinë e linjës dhe me përkrahjen e vazhdueshme të projektit të AT të BE-së. Ky përparim është evidentuar përmes informatave të paraqitura në këtë raport.

Përveç kësaj, ky progres konfirmohet edhe nga institucione të rëndësishme ndërkombëtare, ndërsa së fundi këtë e ka bërë edhe Banka Botërore, përmes projektit “Global Indicators of Regulatory Governance” në të cilin janë përfshirë 187 vende të botës, ku Kosova është radhitur para në mesin e vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe e 24-ta nga të gjitha vendet e përfshira me 4.75 pikë nga maksimumi 5. Krahasuar me vitin 2016 kur Kosova ishte vlerësuar me 4.60 pikë sipas të njëjtit indeks, përparime janë bërë në procesin e politikë bërjes, duke ngritur shkallën e transparencës gjatë hartimit të politikave, përfshirjes më të madhe të palëve të interesit dhe publikut në këtë proces si dhe vlerësimin të ndikimit që kanë këto politika në jetën e qytetarëve. Në fushën e konsultimit Kosova vlerësohet se përmbush të gjitha kriteret sipas të cilave është bërë vlerësimi.<sup>1</sup>

Zbatimi i standardeve për konsultimet publike është një kontribut i drejtpërdrejtë për adresimin e shumë sfidave të identifikuara përmes Strategjisë për bashkëpunim me shoqërinë civile 2019-2023 dhe arritjes së objektivit të parë strategjik të përfshirë në këtë strategji që ka për qëllim “*rritjen e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në politikëbërje*”.

Për të arritur këtë qëllim aktivitetet e ZKM/ZQM-së mbështetur nga projekti i asistencë teknike të Bashkimit Evropian, gjatë vitit 2018 janë përqendruar dhe ka shënuar progres në disa drejtime, si:

- Ngritje e numrit dhe përqindjes së dokumenteve të hartuara që i janë nënshtruar procesit të konsultimit në 96%.
- Rritje të shkallës së plotësimin të standardeve të procesit të konsultimit nga 52% në vitin 2017 në 56% në vitin 2018.
- Arritje e treguesit të prej 57% (caku i SBS-it për vitin 2018 ishte 50%) për standardet e caktuara të konsultimit që ishte pjesë e vlerësimin të SBS-sit ndërsa kjo në realitet reflekton edhe progresin e plotësimin të standardeve të integritimit evropian në kuadër të kësaj fushe.

---

<sup>1</sup> Shih linkun: <http://rulemaking.Worldbank.org/en/data/comparedata/consultation>

- Është rritur përmbajtësisht numri i komenteve të pranuar nga palët e interesit.
- Është forcuar bashkëpunimin më koordinatorët për standardet minimale të ministrive, me zyrat brenda Zyrës së Kryeministrit dhe përgjegjësit tjerë për zhvillimin e konsultimeve publike.
- Përveç mbajtjes së trajnimeve dhe punëtorive me koordinatorët e konsultimeve publike gjithashtu janë mbajtur e trajnimet në vend të punës në ministri të caktuara për të siguruar edhe pjesëmarrjen strukturave tjera të ministrive, veçanërisht departamenteve për hartim të politikave.
- Është bërë avancimi i platformës elektronike për konsultimet publike ku tani disa kategori të statistikave mund të gjenerohen automatikisht nga ana e administrueseve të platformës.
- Ka vazhduar bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile dhe palët e interesit për rritjen e interesit të tyre për të kontribuar në konsultime kualitative.

## 2. Përmbledhje Ekzekutive

Pas miratimit të Rregullores Nr.05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimeve publike (më tutje Rregullores)<sup>2</sup> ky është raporti i dytë vjetor që paraqet progresin për këtë proces. Raporti paraqet punën e bërë gjatë vitit 2018 në zbatimin e standardeve minimale për procesin e konsultimeve publike nga ana e Qeverisë, të udhëhequr nga Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë, në bashkëpunim me të gjitha institucionet tjera të përfshira në procesin e zhvillimit të politikave dhe legjislacionit.

Siç prezantohet në raport, sistemi dhe procesi i konsultimit gjatë vitit 2018 ka shënuar progres në krahasim me vitet e kaluara. Gjatë këtij viti është tejkaluar caku i synuar prej 50% për plotësimin e standardeve të parapara më kontratën e mbështetjes sektoriale buxhetore ndërsa shkalla e përfshirjes në konsultim të dokumenteve të hartuara, shkalla e plotësimit të standardeve dhe numri i komenteve të pranuar nga palët e interesit është rritur në krahasim me vitet e kaluara. Kjo tregon përkushtimin e të gjitha institucioneve që të përfshijnë publikun në procesin e zhvillimit të politikave të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e tyre.

Raporti paraqet në mënyrë të detajuar kategoritë e informatave si në vijim:

- **Numri i përgjithshëm i dokumenteve të hartuara dhe të konsultuara** - Gjatë vitit 2018 gjithsej raportohet se janë hartuar 237 dokumente nga të gjitha ministritë të cilat sipas standardeve minimale do të duhej ti nënshtroheshin procesit të konsultimit publik. Nga ky numër i përgjithshëm, konsultimit publik i janë nënshtuar 228 dokumente (226 përmes platformës ndërsa 2 dokumente janë konsultuar jashtë platformës) apo 96% të numrit të përgjithshëm të dokumenteve të hartuara. Statistikat sipas natyrës së dokumenteve janë: 27 koncept dokumente, 44 projekt ligje, 66 projekt rregullore, 71 projekt udhëzime administrative, 18 draft dokumente strategjike, 8 plane të veprimit dhe 3 dokumente tjera. Të gjitha ministritë (përveç MKK-së) kanë hartuar dhe konsultuar dokumente publike.
- **Plotësimi i standardeve** - Vlerësohet se 127 apo 56 % e dokumenteve të konsultuara i kanë plotësuar standardet minimale të cilat janë paraparë më rregullore ndërsa 101 apo 44% të tyre nuk i kanë plotësuar këto standardet.
- **Pjesëmarrja në proces të konsultimit dhe komentet** - Është raportuar se gjatë procesit të konsultimeve publike gjithsej kanë marrë pjesë 1469 pjesëmarrës të cilët kanë bërë 1930

---

<sup>2</sup> Rregullore (QRK) Nr.05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimit publik, është miratuar në mbledhjen e 86 të Qeverisë së Kosovës, me Vendimin Nr.06/86, datë 29.04.2016.

komente qoftë përmes takimeve, grupeve të punës apo edhe me shkrim. Nga gjithsej 1930 komente, 784 ose 41 % e tyre janë pranuar nga institucionet hartuese, 320 apo 17% prej tyre janë pranuar pjesërisht ndërsa 820 komente ose 42% janë refuzuar, ndërsa për 6 komente nuk është raportuar statusi i tyre. Duhet cekur se për shkak të mungesës së informatave në raport nuk janë paraqitur informatat për pjesëmarrësit, komentet dhe metodat e përdorura përveç platformës për MPB-në, MI dhe MeD.

- **Metodat e përdorura të konsultimit** - Metodë kryesore përmes të cilës janë konsultuar dokumentet e hartuara nga Qeveria është platforma elektronike (e përdorur për 226 dokumente). Përveç publikimit në platformë 91 dokumente (apo 29 % të numrit të përgjithshëm të dokumenteve të konsultuara) janë konsultuar përmes metodës më shkrim elektronik, gjegjësisht përmes e-mailit. Përveç kësaj gjithashtu 16 dokumente apo 7 % janë konsultuar përmes takimeve publike, 12 dokumente apo 5% janë konsultuar përmes punëtorive ndërsa 1 dokument është konsultuar përmes takimit sy më sy.
- **Sfidat dhe rekomandimet** - Përveç punës që është bërë dhe shkallës së respektimit të standardeve minimale, ky raport evidenton sfidat dhe problemet e hasura gjatë punës së zbatimit të këtyre standardeve por jap edhe rekomandimet e duhura për institucionet në mënyrë që të sigurohet proces sa më kualitativ i konsultimeve publike dhe raportim sa më të saktë të rezultateve.

### **3. Metodologjia e raportimit dhe monitorimit të zbatimit të standardeve**

Burimet e informatave për hartimin e këtij raporti janë informatat e dërguara nga koordinorët e konsultimeve publike nga secila ministri pas kërkesës së Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit (ZQM/ZKM) dhe informatat e gjeneruara nga platforma elektronike e konsultimeve publike.

Kërkesës së ZQM/ZKM-së për raportim ju kanë përgjigjur të gjitha ministritë tjera përveç MPB-së, MI-së dhe MeD-së. Raportimi nga koordinorët është bërë përmes formularëve të dizajnuar për mbledhjen e informatave për hartimin e raportit vjetor sipas Rregullores dhe Metodologjisë së Monitorimit dhe Raportimit për zbatimin e standardeve minimale të miratuar nga ZKM në vitin 2017. Duke marrë parasysh që disa nga informatat e raportuara nga ministritë nuk janë përputhur me ato që gjenden në platformë, si dhe ministritë që përmendën më lartë nuk kanë raportuar fare, atëherë informatat plotësuese janë marrë nga platforma elektronike për konsultimet publike.

Kriteret e vlerësimit sipas Rregullores për standardet minimale janë:

- Secili dokument i konsultuar duhet të ketë planin e konsultimit.
- Dokumenti i konsultimit së bashku me dokumentin themelor i cili konsultohet duhet të jetë i publikuar në platformën elektronike për konsultimet publike.
- Afati i konsultimit duhet të jetë së paku 15 ditë pune.
- Raporti i konsultimit duhet të jetë i publikuar në platformë për secilin dokument të konsultuar.
- Dokumenti themelor i konsultimit të jetë i publikuar pas përfshirjes së komenteve dhe propozimeve.

Ky raport mbulon të gjitha dokumentet që kanë qenë pjesë e konsultimeve publike gjatë periudhës 01 janar 31 dhjetor përfshirë edhe dokumentet që fazën e konsultimeve me publikun e kanë filluar në fund të vitet 2017 dhe procesi i konsultimit ka përfunduar në vitin 2018, ndërsa dokumentet që kanë filluar procesin e konsultimeve në fund të viti 2018 dhe ka vazhduar në vitin 2019, nuk janë përfshirë në raportin vjetor të vitit 2018.

- Dokumentet të cilat janë publikuar në platformë në fund të vitit 2017 ndërsa konsultimi është mbyllur në fillim të vitit 2018 janë përfshirë në raport të konsultimit për vitin 2018, pasi që shumica e standardeve minimale lidhen me procesin e konsultimit pas mbylljes së procesit të konsultimit. Këtu kemi të bëjmë me shqyrtimin e komenteve dhe propozimeve, përfshirja e tyre në dokumentin themelor, pastaj hartimi dhe publikimi i raportit të konsultimit dhe versionit përfundimtar të dokumentit themelor.
- Dokumentet të cilat janë publikuar nga platformë në dhjetor të vitit 2018 ndërsa konsultimi ka vazhduar edhe në vitin 2019, nuk janë përfshirë në raportin vjetor të vitit 2018.

Për vlerësimin e treguesve sipas kontratës së SBS-it përfshihen vetëm koncept dokumentet, projekt ligjet, programet dhe dokumentet strategjike, për dallim nga vlerësimi i përgjithshëm i standardeve sipas rregullores kur përfshihen edhe aktet nënligjore dhe dokumente tjera. Gjithashtu për dallim nga vlerësimi i përgjithshëm, për arritjen e treguesit të SBS, në vlerësim përfshihen vetëm dokumentet për të cilat qeveria gjithashtu ka marrë vendim deri në momentin e hartimit të këtij raporti. Ndërsa për vlerësimin e plotësimin të të gjitha standardeve sipas Rregullores në vlerësim përfshihen të gjitha dokumentet të cilat janë hartuar dhe konsultuar gjatë vitit 2018 pavarësisht a janë miratuar apo ende nuk janë miratuar nga Qeveria .



#### 4. Platforma online për konsultimet publike

Platforma online është instrumenti kryesor për zhvillimin e konsultimeve publike e cila ofron mundësinë që publiku të ofrojë kontributet e tyre online për projekt dokumentet që hartohen nga ana e Qeverisë. Platforma e cila është funksionalizuar në fillim të vitit 2017, ka vazhduar që të pasurohet dhe promovohet duke bërë kështu që të kemi një rritje të theksuar të regjistrimit të përdoruesve të rinj, abonim të tyre për të marrë informacione në kohë reale lidhur me publikimin e dokumenteve për konsultim si dhe mundësinë që ofron platforma që secili individ, institucion apo palë e interesuar të jep kontributin e vet në përmirësimin e legjislacionit për miratim nga Qeveria dhe institucionet vartëse të saj.

Si rezultat i kërkesave të reja, platforma gjatë vitit 2018 është avancuar edhe me modulën e gjenerimit të statistikave dhe paraqitjes së tyre vizuale (shih Fig 2). Si rezultat koordinatorët e ministrive kanë qasje në gjenerimin e informatave për konsultimet e zhvilluara nga ana e tyre ndërsa administratori qendror që mbahet nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit ka qasje në gjenerimin e përgjithshme të statistikave të në nivel të Qeverisë.

Komponentët në cilat mund të gjenerohen informata përmes platformës janë si në vijim:

- Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas institucioneve;
- Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas aktivitetit të bashkëpunëtorëve;
- Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas publikimit të raporteve finale;
- Shfrytëzuesit e platformës;
- Regjistri i dokumenteve të konsultuara dhe
- Informata për treguesit e SBS-it.




Figura 1: moduli i gjenerimit të statistikave

Moduli i gjenerimit të statistikave nga platforma e konsultimeve ndihmon në monitorimin dhe informimin e procesit të zbatimit të standardeve minimale për procesin e konsultimeve publike. Por jo të gjitha informatat të cilat kërkohet për të raportuar për procesin e konsultimeve mund të nxirren përmes platformës, gjegjësisht këtij moduli. Këtu përfshihen:

- Dokumentet të cilat nuk kalojnë procesin e konsultimit apo nuk konsultohen përmes platformës;
- Informatat për pjesëmarrësit në procesin e konsultimeve përmes metodave tjera përveç platformës;
- Informatat për komentet dhe propozimeve të cilat ofrohen përmes metodave tjera përveç platformës;
- Informatat për metodat e përdorura gjatë procesit të konsultimeve publike përveç platformës.

Këto informata mund të nxjerrën nga platforma nëse janë në raportet individuale të secilit dokument të publikuar. Megjithatë, publikimi i këtyre raporteve mungon për disa nga dokumentet e konsultuara.

## 5. Bashkëpunimi dhe ngritja e kapaciteteve për konsultimet publike

Gjatë vitit 2018 Zyra për Qeverisje të Mirë/ Zyra e Kryeministrit kanë vazhduar aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve dhe bashkëpunimit si brenda ashtu edhe në nivel rajonal me qëllim të shkëmbimit të përvojave më të mira për procesin e konsultimeve publike.

Me datë 16 dhe 17 tetor 2018 Zyra e Kryeministrit gjejjësisht Zyra për Qeverisje të Mirë në bashkëpunim me Shkollën Regjionale për Administratë Publike-ReSPA dhe Këshillin Rajonal për Bashkëpunim-RCC kanë organizuar seminarin për procesin e konsultimeve me publikun në Kosovë dhe vendet e rajonit. Në këtë seminar janë trajtuar tema dhe praktika nga vendet e rajonit si përvojat e Sllovenisë, Shqipërisë, Maqedonisë, Serbisë, Malit të Zi dhe Kosovës por edhe me vendet më të zhvilluara. Seminari ishte një mundësi e jashtëzakonshme e Zyrës për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit për të prezantuar para vendeve të rajonit jo vetëm raportin e konsultimeve me publikun për vitin 2017, por për të ndarë praktikat e Kosovës për zhvillimin e procesit të konsultimeve qysh nga fillimi i procesit e deri tani dhe për të gjitha zhvillimet që e kanë përcjellë këtë proces.

Nën menaxhimin e Zyrës për Qeverisje të Mirë dhe me mbështetjen e projektit të KE-së ngritja e kapaciteteve gjatë këtij viti është bërë përmes punëtorive të organizuara me të gjitha ministrinë përmes koordinatoreve të konsultimeve dhe trajnimi në vend të punës për ministri të përzgjedhura.

Punëtori me të gjithë koordinorët e ministrive janë mbajtur si në vijim:

Me 19 korrik 2018 është mbajtur punëtorja me koordinorët e konsultimeve në ministri ku është diskutuar:

- Raporti për zbatimin e standardeve minimale për vitin 2017;
- Procesi i zbatimit të standardeve minimale për 6 mujorin e parë 2018;
- Zbatimi i kritereve të kërkuara nga treguesi i SBS-së për konsultimet publike dhe obligimet që dalin nga ky tregues.

Me 5 tetor 2018 është mbajtur punëtorja me koordinorët e konsultimeve publike ku janë diskutuar:

- Përgjegjësia institucionale për zbatimin dhe progresin në arritjen e treguesit të SBS-it për procesin e konsultimeve publike gjatë vitit 2018
- Përgjegjësia e institucioneve për raportim dhe rezultatet e konsultimit
- Raportimi vjetor dhe për rezultatet e konsultimeve
- Funksionet e reja për raportim

Në këtë punëtori kanë marrë pjesë 17 përfaqësues të ministrive, ZKM-së dhe projektit të KE-se për mbështetje ZQM-së.

Me 27 Dhjetor është mbajtur punëtorja për Platformën online të konsultimeve publike dhe risitë e zhvilluara në këtë platformë gjatë vitit 2018.

Trajnimet në vendin e punës të mbajtura për 4 ministri si në vijim.

- Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe teknologjisë me datë 13 nëntor me 13 pjesëmarrës;
- Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sporteve me datë 21 nëntor 2018 me 11 pjesëmarrës;
- Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale me datë 6 dhjetor 2018 me 7 pjesëmarrës;
- Ministrinë e Punëve të Brendshme mbajtur me 26 dhjetor 2018 me 8 pjesëmarrës.

Në këto trajnime kanë përfituar gjithsej 36 zyrtarë të këtyre ministrive dhe janë prezantuar dhe diskutuar standardet që duhet të plotësohen, dokumentet që duhet të hartohen gjatë konsultimit, shembuj nga konsultimet e mëhershme etj.

## 6. Ndërlidhja e procesit të konsultimeve me publikun me zbatimin e indikatorëve të SBS-së

Përveç raportimit për zbatimin e rregullores për standardet minimale Zyra për Qeverisje të mirë monitoron zbatimin e standardeve minimale që kanë për qëllim matjen e indikatorit II “*Komunikimi efektiv publik, konsultimi publik dhe pjesëmarrja e palëve të interesuara*” i sipas Marrëveshjes për Përkrahje Direkte Buxhetore (SBS) në kuadër të IPA 2 e cila marrëveshje ofron përkrahje buxhetore në vlerë prej 25 milion euro për Kosovën. Indikatori i konsultimeve publike në SBS, gjatë vitit 2018 synon konsultimin e së paku 50% të projekt strategjive/politikave sektoriale/koncept dokumenteve dhe ligjeve primare, të cilat janë miratuar nga qeveria në vitin 2018, në përputhje standardet e përcaktuara, për vitin 2019 - 70 % dhe për vitin 2020 plotësimi standardeve duhet të jetë në shkallën 100%.

Në vlerësim të arritjes së treguesit të SBS-së hyjnë dokumentet:

- Draft Strategjitë dhe Programet
- Draft ligjet dhe
- Draft koncept dokumentet të cilat janë hartuar gjatë vitit 2018

Për të vlerësuar arritjen e caqeve të përcaktuara me kontratën e SBS-it kërkohet vlerësohen kriteret si në vijim :

- Planifikimi i konsultimeve - zhvillimi i planeve të konsultimit për secilën strategji, koncept dokumentet dhe propozimi legjislativ (neni 11 i Standardeve Minimale)
- Përgatitja e një dokumenti konsultimi për çdo dokument të konsultuar të publikuar në platformën online (shpjegimi i problemeve dhe objektivave kryesore, qëllimi i konsultimit, ndikimi i pritur në grupet e synuara, çështjet kyçe të adresuara nga projekt-politika / akti etj.)
- Kryerja e konsultimeve publike për të paktën 15 ditë pune (ose 3 javë) përmes platformës online, dhe
- Përgatitja e një raporti përfundimtar me rezultatet e konsultimeve publike (me pasqyrën e përpunimit të arsyeve për pranimin / refuzimin e komenteve të caktuara) dhe botimin e tij në platformën online.

Këto kriteret janë të bazuara në Rregulloren për standardet minimale për konsultimet publike.


<b>Perlllogaritja e Treguesve te perkrahjes buxhetore sektoriale nga BE</b>			
<b>Lloji i iniciativës</b>	<b>Nuk plotëson standardet</b>	<b>Plotëson standardet</b>	<b>Total</b>
Koncept dokumente	10	17	27
Programe		3	3
Strategji	6	3	9
Ligje	18	25	43
<b>Total</b>	<b>34</b>	<b>48</b>	<b>82</b>
<b>Përqindja e treguesve</b>	<b>41%</b>	<b>59%</b>	<b>100%</b>

Tabela 1: Plotësimi i standardeve për treguesit e SBS


Në kuadër të kornizës së kushteve të treguesit të SBS-it gjatë vitit 2018 janë konsultuar 82 dokumente. Nga këto standardet e SBS-së i plotësojnë 48 dokumente apo 59% të tyre, ndërsa 34 dokumente ose 41% e tyre nuk i plotësojnë standardet (shih tabela 1).

## 7. Numri i përgjithshëm i projekt dokumenteve


Gjatë periudhës janar-dhjetor 2018 Qeveria e Republikës së Kosovës ka hartuar 237 dokumente të cilat është dashur ti nënshtrihen procesit të konsultimit publik sipas rregullores për standardet minimale (shih Fig nr. 2).



Nga këto dokumente institucionet hartuese i kanë konsultuar gjithsejt 228 ndërsa 9 dokumente nuk janë konsultuar fare apo shprehur në përqindje 96% e dokumenteve janë konsultuar ndërsa vetëm 4% nuk janë konsultuar (shih Fig. 2). Kjo paraqet një shkallë më të lartë të konsultimit në krahasim me vitin paraprak (2017) kur nga 245 dokumente gjithsej 221 janë konsultuar ndërsa nuk ishin konsultuar 24 dokumente.



Numri më i madh i dokumenteve të cilat janë hartuar gjatë vitit 2018 ashtu si edhe në vitin paraprak i përket kategorisë së akteve nënligjore, ku prijnë udhëzimet administrative (71 udhëzime administrative, 63 nga to janë konsultuar ndërsa 8 nuk kanë kaluar në proces të konsultimit) pastaj rregulloret (gjithsej 66 ku të gjitha kanë kaluar në proces të konsultimit) dhe 43 projekt ligje nga to vetëm një nuk kanë kaluar në proces të konsultimit publik, pastaj 18 dokumente strategjike, 8 plane te veprimit dhe 3 dokumente tjera (Fig nr. 3 dhe 4).




Duhet cekur se në listë të dokumenteve jo të konsultuara nuk janë përfshirë ato të cilat sipas nenit 17 të rregullores janë të përjashtuara nga procesi i konsultimit. Numri më i madh i dokumenteve që janë miratuara nga qeveria e që hyjnë në këtë kategori janë marrëveshjet ndërkombëtare.

## 8. Shkalla e plotësimit të standardeve minimale

Numri i dokumenteve të cilat i janë nënshtruar konsultimit më publikun është shumë e lartë (96%). Por edhe shkalla e plotësimit të standardeve minimale të procesit të konsultimit ka shënuar progres në krahasim me vitin e kaluar. Vlerësimi i plotësimit të standardeve minimale i paraqitur në këtë raport bazohet në informatat e dërguara nga ana e koordinatorëve të ministrive, por edhe nga platforma elektronike për konsultime publike. Vlerësohet se nga numri i përgjithshëm i dokumenteve të konsultuara (228 dokumente), standardet minimale të parapara me rregullore i plotësojnë gjithsej 127 apo 56% ndërsa numri i dokumenteve të cilat nuk kanë plotësuar të gjitha standardet minimale janë gjithsej 101 dokumente apo 44% (fig. 5). Kjo paraqet numër më të madh dhe përqindje më të lartë të dokumenteve që i kanë plotësuar standardet në krahasim me vitin e kaluar, (në vitin 2017 kishin plotësuar standardet 116 dokumente apo 52% të dokumenteve të konsultuara ndërsa numri i dokumenteve që nuk e kanë plotësuar të gjitha standardet është 105 apo 48 % të dokumenteve. Ndër standardet që në shumicën e dokumenteve nuk përmbushen janë publikimi i raportit të konsultimit dhe dokumenti i konsultimit. Gjithashtu shumë dokumente nuk e kanë të publikuar dokumentin e konsultimit apo nuk e respektojnë kohëzgjatjen e konsultimit prej 15 ditë pune ashtu siç kërkohet shprehimisht me rregullore.


FIG. NR. 5. SHKALLA E PLOTESIMIT TE STANDARDEVE



- **Ministritë të cilat kanë plotësuar standardet** plotësisht janë: MF në 16 dokumente, MAPL në 10 dokumentet e konsultuara dhe MIE e cila kishte konsultuar vetëm një dokument (fig nr. 6)
- **Ministritë që kanë plotësuar standardet mbi 75%:** MZHE nga 14 dokumente 3 nuk i kanë plotësuar standardet, MSH nga 11 dokumente që kanë kaluar në proces të konsultimit 3 nuk i kanë plotësuar të gjitha standardet sipas rregullores, pastaj MAP nga 6 dokumente, një nuk i ka plotësuar standardet, MFSK nga 5 dokumente një nuk i ka plotësuar standardet.
- **Ministritë që kanë plotësuar standardet mbi 50%** e kanë dokumentet e konsultuara nga MTI nga 24 dokumente në 16 i ka plotësuar standardet minimale, MPMS nga 15 dokumente gjithsej në 6 dokumente nuk i ka plotësuar të gjitha standardet, MI nga 22 dokumente në 15 i ka plotësuar standardet, dhe ZKM ka plotësuar standardet në gjysmën e dokumenteve të konsultuara.
- **Ministritë që kanë plotësuar standardet nën 50%** janë MKRS nga 16 dokumente në 7 i plotësojnë standardet, MD nga 17 dokumente vetëm 7 i kanë plotësuar standardet, MMPH nga 9 dokumente 4 i kanë plotësuar standardet dhe MPB nga 27 dokumente të hartuara vetëm 1 ka plotësuar të gjitha standardet minimale.
- **Ministritë që nuk asnjë dokument nuk plotëson të gjitha standardet** hyjnë MBZHRD, MPJ, MIN, MZHR (shih fig. 6 më poshtë)



FIG. NR. 6. PLOTESIMI I STANDARDEVE SIPAS MINISTRIVE



## 9. Metodatat e përdorura gjatë procesit të konsultimeve

Kualiteti i procesit të konsultimit varet në masë të madhe nga përzgjedhja e metodave të konsultimit. Përzgjedhja e metodave adekuate për procesin e konsultimit ndikon në qasjen e kategorive të ndryshme të palëve të interesit në ofrimin e propozimeve të tyre në dokumentet që hartohen. Përzgjedhja adekuate e metodave mund të bëhet vetëm nëse në fillim të procesit të hartimit të dokumenteve apo konsultimit bëhet analiza e mirëfilltë e palëve të interesit. Konsultimi përmes platformës elektronike është një nga standardet minimale që parashihet me rregullore (neni 12). Megjithatë përdorimi i platformës nuk përjashton përdorimin e metodave të tjera të konsultimit (neni 12 para. 10) të cilat janë paraparë me nenin 7 të Rregullores.

Sipas informatave të siguruar nga procesi i konsultimit nga 228 dokumente të konsultuara dy nuk janë publikuar në platformë (një dokument nga MSH dhe një nga MZHE). Përveç publikimit në platformë, 91 dokumente (apo 29 % të numrit të përgjithshëm të dokumenteve të konsultuara) janë konsultuar edhe përmes metodës më shkrim elektronik, gjegjësisht përmes e-mailit. Përveç kësaj gjithashtu 16 dokumente apo 7 % janë konsultuar edhe përmes takimeve publike, 12 dokumente apo 5% janë konsultuar edhe përmes punëtorive ndërsa 01 dokument është konsultuar edhe përmes takimit sy më sy. Metodatat tjera si konferencat, hulumtimet e opinionit, etj. nuk janë përdorur apo ministratë nuk i kanë raportuar se janë përdorur (tabela nr. 2).

Institucionet të cilat kanë përdorur më së shumti metoda të konsultimeve janë MTI dhe MASHT-i të cilat përveç publikimit në platformë ka përdorur edhe konsultimin me shkrim, takime publike, takime me grupe të interesit dhe punëtori. Gjithashtu metoda të ndryshme të konsultimit përveç publikimit në platformë kanë përdorur ZKM, MF, MAP kanë përdorur 3 metoda të konsultimeve, dy metoda të konsultimit kanë përdorur MZHE, MFSK, MeD, MD dhe MSH ndersa ministrinë tjera kanë përdorur vetëm një metodë, gjegjësisht platformën elektronike të konsultimeve (shih tabela nr. 2).

	KONSULTIME ME SHKRIM	PLATFORMA	TAKIME PUBLIKE	TAKIME SY ME SY	PUNËTORI	NUMRI I METODAVE TË
ZKM		20 <sup>3</sup>	8		8	3
MZHE	14	13				2
MTI	18	23		1	1	4
MPMS		15				1
MPB		27				1
MMPH		9				1
MFSK	5	5				2
MF	16	16	1			3
MAPL		10				1
MI		22				1
MAP	5	6	5			3
MeD		2				2
MD	15	15				2
MTE		1				1
MSH	11	11				2
MKRS		12				1
MBZHRD		1				1
MASHT	5	5	2		3	4
MPI		1				1
MTN		3				1
MZHR		3				1

Tabela 2. Metodatat e konsultimit të përdorura sipas ministrive

## 10. Niveli i pjesëmarrjes së publikut në proces të konsultimeve

Informatat për numrin e pjesëmarrësve janë marrë përmes raporteve të dërguara nga ana e koordinatoreve të konsultimeve publike. Pasi që raporti për MPB, MI dhe MeD-në është bazuar platformën elektronike, për këto ministri mungojnë informatat për pjesëmarrjen e qytetarëve në proces të konsultimit jashtë platformës. Raportohet se nga 228 dokumente të konsultuara, gjithsej janë regjistruar 1469 pjesëmarrës. Numër të madh të pjesëmarrësve e ka të regjistruar MTI ku për 23


<sup>3</sup> Paraqet numrin e dokumenteve të konsultuara përmes kësaj metode. E njëjta vlen edhe për statistikat tjera të paraqitura në këtë tabelë.

dokumente ka raportuar për pjesëmarrjen e 400 pjesëmarrësve, MAPL për 10 dokumente të konsultuara kemi 419 pjesëmarrës, MASHT për 5 dokumente ka raportuar 165 pjesëmarrës, ndërsa MPMS për 15 dokumente të konsultuara ka raportuar për 111 pjesëmarrës (Fig. nr. 9 seksionin 11 në vijim).

## 11. Numri dhe statusi i komenteve


Përmes procesit të konsultimit synohet që gjatë hartimit të dokumenteve të politikave dhe legjislacionit të mbrohet interesi i publikut. Prandaj publiku dhe palët e interesit përmes propozimeve dhe komenteve paraqesin më së miri se cili është interesi i tyre që synohet të arrihet me këto dokumente. Prandaj sa ma më i madh të jetë numri i komenteve konsultimi vlerësohet të jetë më kualitativ.

Gjatë vitit 2018 nga 228 dokumente të cilat kanë kaluar në proces të konsultimit, numri i përgjithshëm i komenteve të pranuar është 1930. Sa i përket statusit të komenteve llogaritet se nga 1930 komente, 784 ose 41 % e tyre janë pranuar nga institucionet hartuese, 320 apo 17% prej tyre janë pranuar pjesërisht ndërsa 820 komente ose 42% janë refuzuar, ndërsa për 6 komente nuk ka informata nëse janë pranuar apo refuzuar (shih fig. 7).




Sipas informatave të nxjerra nga platforma vlerësohet se nga numri i përgjithshëm 1930 i komenteve të ofruara 139 apo 7% nga to janë ofruar përmes platformës elektronike ndërsa komentet tjera janë ofruar përmes metodave tjera të konsultimit. Komente përmes platformës kanë marrë më së shumti MAPL ku nga 251 përmes platformës janë ofruar 70 apo 22% e komenteve dhe MAP nga 237, 23 apo 9% janë ofruar përmes platformës elektronike (shih fig. nr. 8). Vlen të theksohet se platforma është instrument i obligueshëm dhe në të cilën ministritë i publikojnë pothuajse të gjitha dokumentet gjatë

konsultimit, si dhe shërben një mjet shumë i rëndësishëm ku të gjithë mund të kenë qasje në dokumentet e konsultuara. Por përdorimi i saj nga ana e përdoruesve sipas statistikave të paraqitura përbën një sfidë e cila duhet të merret parasysh nga Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë dhe ministrinë.



Në grafikun në vazhdim pasqyrohen informatat krahasuese sipas ministrive për numrin e dokumenteve të konsultuara, numrit të pjesëmarrësve dhe numri i komenteve. Vlen të theksohet se pjesëmarrja e publikut në procesin e konsultimeve sipas të dhënave ndryshon nga ministria në ministri. Statistikat e pjesëmarrjes, numrit të dokumenteve të konsultuara si dhe numrit të komenteve në shumicën e rasteve janë jo proporcionale me njëra tjetrën (Fig. nr. 8).



## 12. Statistikat krahasuese 2017 dhe 2018


Volumi i aktiviteteve të ministrive për procesin e konsultimit gjatë vitit 2018 nuk dallon shumë nga viti paraprak. Qëllimi kryesor gjatë viti 2018 ka qenë përfshirjes së të gjitha dokumenteve në proces të konsultimit, rritja e numrit të dokumenteve që i plotësojnë standardet dhe përmirësimi i cilësisë së konsultimeve.

**Gjthëpërfshirja** - Numri i përgjithshëm i dokumenteve të hartuara gjatë vitit 2018 nuk dallon shumë në krahasim me vitin 2017. Gjatë vitit 2018 janë hartuar vetëm 7 dokumente më pak (viti 2017: 245 dokumente ndërsa viti 2018: 237 dokumente) ndërsa për kohëzgjatje janë konsultuar 7 dokumente më shumë (viti 2017: 221 ndërsa viti 2018: 228 dokumente). Kjo tregon se numri i dokumenteve të përfshira në proces të konsultimit gjatë vitit 2018 është rritur)

**Shkalla e plotësimit të standardeve** –gjithashtu gjatë vitit 2018 ka shënuar një rritje prej 4% në krahasim me vitin 2017. D.m.th. numri i dokumenteve që i plotësojnë standardet gjatë vitit 2018 ishte 127 ndërsa nuk i kanë plotësuar standardet 101 dokumente në krahasim me vitin 2017 kur ky numër ishte 116 ndërsa nuk i kishin plotësuar standardet 105 dokumente.

**Kualiteti i konsultimit** – metodologjia e përdorur për hartimin e këtij raporti dhe burimet e alokuara nuk ofrojnë shumë mundësi për të bërë vlerësimin e plotësimit të standardeve nga aspekti kualitativ.

